

11.03.2021
Ora 17:00

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|-----------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj, M.Koja, E.Meta |
| Parti | Politike: | PD, LSI, PDIU, PBK, LN, PSD |

Zj. I. Nano: Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar zyrtarisht për t’u zhvilluar ditën e sotme në orën 17:00. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi projektaktin për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet në Kuvend. Verifikojmë kurumin, janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator kështu që mbledhjen mund ta nisim, janë të pranishëm përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore të akredituara në KQZ. I pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, zoti Merkaj si dhe zyrtarë të KQZ-së. Sipas nenit 23 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator para se të fillojmë shqyrtimin e aktit që kemi në rendin e ditës po j’u drejtohem

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

pjesëmarrësve së pari anëtarëve të Komisionit rregullator nëse ka ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për tu diskutuar ?

Zoti Çakaj?

Z. M. Çakaj: Faleminderit zonja Kryetare. Unë kisha një çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Është e disata herë që e kemi ngritur si shqetësim dhe vlen që ta sjellim dhe në mbledhjen e sotme. Çështjen e skadimit të dokumeëntave të identifikimit, karta ID apo pasaporta biomentrike si mjetet e vetme të cilat janë parashikuar në kodin zgjedhor për të votuar. Meqenëse këtu është dhe prezent sekretari i përgjithshëm i KQZ-së në dijeninë time por besoj në dijeninë e të gjithëve është drejtuar një shkresë nga KQZ-ja drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile lidhur së pari me numrin e shtetasëve të cilët nuk e kanë rinovuar akoma dokumentin e ID dhe së dyti nëse është ndërmarrë ndonjë akt qoftë i Ministrisë të Brendshme Qoftë dhe i Qeverisë Shqiptare lidhur me zgjatjen e vlefshmërisë së këtyre dokumentave identifikimi. Do të dëshiroja të informohesha nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së nëse kemi ndonjë përgjigje ose ndonjë informacion të mëtejshëm, faleminderit.

Zj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj. Zoti Merkaj mundeni nëse keni ndonjë informacion në përgjigje të shqetësimi?

Z. Y. Merkaj: Po, që në mbledhjen e kaluar kur është ngritur shqetësimi për lëshimin e kartave KQZ-ja i ka drejtuar kërkesë Ministrisë të Brendshme zotit Çuçi, ku i ka kërkuar të zgjatet afati i vlefshmërisë së kartave deri në datën 12Maj kshu që kalohet ajo data kur është procesi i votimit. Kërkesa është bërë që atë ditë.

Z. M. Çakaj: Kemi përgjigje?

Z. Y. Merkaj: Jo, përgjigje nuk kemi derimë sot.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Z. M. Çakaj: Faleminderit!

Zj. I. Nano: Po, zonja Vukaj.

Zj. H. Vukaj: Meqenëse çështja është kaq thelbësore dhe kaq e nxehtë dhe afati njëkohësisht shumë i shkurtër. Në këtë kuadër do të kërkoja që dhe prezenca e Drejtorit të Përgjithshëm në një nga mbledhjet tona do të ishte shumë e rëndësishme për ne. Për ta pyetur drejtpërdrejt për këto ecejaket burrokratike dhe ndoshta do vononin ose ndoshta n'a shtyjnë atë pritshmërinë, faleminderit!

Zj. I. Nano: E vlerësojmë kërkesën dhe ndoshta e thërrasim në mbledhjen e ardhshme.

Z. Y. Merkaaj: Mendojë se i është dërguar shkresa Ministrit të Brendshëm jo Drejtorit të Përgjithshëm?

Z. M. Çakaj: Jo, ishte për një informacion të detajuar lidhur me numrin e shtetasve të cilët nuk e kanë të rinovuar dokumentin e identifikimit, qoftë kartë apo pasaporte biometrike?

Z. Y. Merkaaj: Këtë përgjigje e kemi ne!

Z. M. Çakaj: Besoj në kohë reale se është proces dinamik?

Z. Y. Merkaaj: Jo, se kemi!

Zj. I. Nano: Në këtë rast do të vendoset nga ana e Autoriteteve të Përgjithshme. Besojë nga ana e Ministrave për zgjatjen e afatit të dokumentave. Pra bie kërkesa

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

për të ditur numrin e shtetasve të cilët nuk e kanë një dokument të vlefshëm identifikimi në datën e zgjedhjeve. Faleminderit, çështje tjetër jashtë renditës ditës kolegjë, kemi? Atëherë fillojmë me rendin e ditës.

Sot kemi për shqyrtim projektaktin “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”. Le të mbajmë një fakt që komisioni Rregullator ka në kompetencën e vet miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit ku një nga elementet e përmbajtjes së fletës së votimit është dhe renditja e subjekteve zgjedhore e cila do të bëhet me short. Para së të bëhet shorti duhet të miratojmë rregullat dhe pikërisht projektvendimi që kemi sot për të shqyrtuar. Pra si rradhë veprimesh do të jetë ky, së pari shqyrtohet dhe miratohet sot ky projektvendim për procedurën e hedhjes së shortit më tej është administrata e KQZ-së që në momentin e përfundimit të verifikimit të listave që janë depozituar në KQZ nga ana e subjekteve zgjedhore. Do të zhvillojë shortin dhe më tej akoma kur të vi momenti KQZ-ja do të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit. Për të prezantuar aktin në mënyrë më të përmbledhur ftojë zotin Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 98 të paragrafit 5, të Kodit Zgjedhor KQZ-ja organizon hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listave shumëmemërore në KQZ sipas rastit në KZAZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së. Referuar paragrafit 4, neni 12, të Kodit Zgjedhor organi kompetent për miratimin e akteve me karakter negativë është pikërisht Komisioni Rregullator. Në zbatim të dispozitave të mësipërme të cilat përcaktojnë kompetencat e Komisionit Rregullator është hartuar projektvendimi i mësipërm. Ky projektvendim përcakton rregullat për hedhjen e shortit për përcaktimin e renditjes në fletën e votimit të subjekteve zgjedhore. Projektvendimi përmban 7 nene ku përcaktohet hedhja e shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

zgjedhjet për Kuvend për veprimet paraprake të hedhjes së shortit si dhe dhe procedura e hedhjes së shortit për përcatimin e renditjes së subjekteve zgjedhore. Së fundi vendimi parashikon miratimin e rezultatit të shortit, ankimimin dhe hyrjen në fuqi të vendimit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokuntacionin përkatës, faleminderit.

Zj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj. Të nderuar kolege fillojmë diskutimin në parim lidhur me projektvendimin “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”. Sipas rregullores së pari në këtë moment, pra diskutimi në parim e kanë fjalën anëtarët e Komisionit Rregullator. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë diçka për të shtuar. Atëherë kalojmë në parimin në votim të projektvendimit.

Kush është dakord në parim me projektvendimin?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektvendimit. Projektvendimi ka 7 nene: Neni 1 “Objekti dhe Qëllimi” ky vendim synon të përcaktojë rregulla për hedhjen e shortit për përcaktimin e renditjeve së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit duke u bazuar në parimin e transparencës dhe barazisë. Ndalohet përdorimi i celularëve dhe pajisjeve të tjera thotë rregullorja e Komisionit Rregullator. Po e lexojë dhe njëherë “ Ky vendim synon të përcaktojë rregulla për hedhjen e shortit për përcaktimin e renditjeve së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit duke u bazuar në parimin e transparencës dhe barazisë”. Sipas rregullores në diskutimin nen për nen së pari e marim fjalën nëse deshirojnë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, më pas anëtarën e Komisionit Rregullator. Të nderuar, keni propozim

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

për shtesa, ndryshime në nenin 1? Atëherë kalojmë në parimin në votim të nenit 1.

Kush është dakord në parim me nenin 1?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni1!

Neni 2 “Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvend”

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Do t'i kërkoja administratës besoj është çështje korigjimi material, duhet të theksojmë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, apo do ta do ta lemë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë më mirë pa cituar datën.

Neni 2.

Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit në zgjedhje për Kuvendin e Shqipërisë.

1. Renditja e subjekteve zgjedhor, parti politike, koalicione zgjedhore të cilët kanë regjistruar listat shumemërore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë bëhet me short.

2. Në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen kandidatë të propozuar nga zgjedhësit renditja midis këtyre përcaktohen me short. Në renditjen përfundimtare të fletës së votimit, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit vendosen pas renditjes së subjekteve zgjedhore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në rast se për një zonë ka vetëm një kandidat të propozuar nga zgjedhësit nuk hidhet short.

3. Në rast se në përfundim të hedhjes së shortit renditen njëri pas tjetrit subjektet zgjedhor, të cilët kanë emrin zyrtar emblemën (siglën) apo shkronjat nistore të përafërta dhe që mund të shkaktojnë konfuzion apo lajthitje te votuesit shorti përsëritet por jo më shumë se tre herë. Në rast se edhe pas hedhjes së tretë të shortit përsëri renditen njëra pas tjetrës parti koalicione që kanë emrin zyrtar emblemën siglën apo shkronjat nistore të përafërta, ato do të zhvendosen në renditje deri në katër rradhë. Atëherë çelim diskutimin për nenin 2.

Z. D. Prenga, përfaqësues i Partisë LN: Duke e parë aktin në formë dhe në terësinë e tij shikoj që ky nen është i panevojshëm pasi i mungon objekti për t'u rregulluar. Akti flet për hedhjen e shortit, pra, në kuptimin e terësisë së aktit po

7

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

dhe në pjesën lëndore që mendohet të rregullohet kjo pikë çmoj se është e panevojshme. Nuk ekziston objekti për t'u rregulluar pasi nënteksti i këtij neni lidhet me nenin 66 të Kodit Zgjedhor që përcakton regjistrimin e subjekteve. Çmoj se subjektet e regjistruara e kanë përmbushur tashmë atë detyrim dhe KQZ-ja në çastin e regjistrimit e ka kryer verifikimin e mospërplasjes së emrave apo elementeve të tjerë të përcaktuar në nenin 66 në kuptimin e lajthitjes së zgjedhësve. Në këtë sens mendoj se pavarësisht se mund të kemi ndonjë objeksion në lidhje me preogativën koresponduese të këtij neni, por për sa i takon këtij akti ky nen e ka të preziomuar pjesën për t'u rregulluar dhe nuk ka pse të jetë. Nuk mund të pranojmë dhe një akt normues që ka një element të paplotësuar ligjor apo në paligjshmëri që pastaj do të rregullohet me një akt normues aq më tepër duket sikur i jep sensin retroaktiv gjithë aktin në terësi, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit, përfaqësues të tjerë të subjekteve të tjera zgjedhore? Ju lutem nga propozuesit, një koment për propozimin e zotit Prenga për ta hequr fare këtë nen.

Znj. H. Vukaj: Ne mendojmë që neni është në përputhje me autorizimin ligjor dhe parandalon në një situatë eventuale të ndonjë ngjashmërie midis siglave emblemave apo shkronjave nistore të koalicioneve apo të partive politike subjekteve zgjedhore të regjistruara. Kështu që unë mendoj që neni duhet të qëndroj në formën e paraqitur.

Znj.I.Nano: Faleminderit!



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Z. M. Çakaj: Në gjykimin tim dhe vlerësimin tim personal, unë mendoj se nuk bie dakord që është e panevojshme, por përkundrazi është i domosdoshëm neni 2 të renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit në zgjedhjet për Kuvend pasi së pari kemi të bëjmë me dy momente procedurale të ndryshme, momenti procedural që identifikon dhe parashikon neni 66 i Kodit Zgjedhor është momenti i parë i regjistrimit të një partie dhe ta materializojmë me shembull nëse një subjekt do të kishte emrin AB, dhe nëse një subjekt tjetër do të kishte emrin AB-C, ose AB- një shkonjë tjetër, automatikisht do të ishim në kushtet e nenit 66 pasi paraqitja për regjistrim i këtij subjekti dytë do të shkaktonte konfuzion ose lajthitje të votuesve. Ligjvënësi ka parashikuar në këtë moment procedural veprimin kryesisht të KQZ-së pasi vihet në dijeni të këtij fakti ose regjistron partinë sic e ka parashikuar norma duke marrë në konsideratë datën e themelimit ligjor pra datën e parë ose nuk e pranon atë të pandryshueshme nistore. Ndërsa neni 2 i përcaktuar dhe i paraqitur si projektvendim për t'u miratuar si akt normativ nga ana e Komisionit Rregullator e ka tejkaluar këtë fakt e ka ezauruar KQZ-ja veprimin e parë procedural dhe thjesht rregullon normon renditjen e subjekteve zgjedhore. Pra, përtej kësaj lajthitje neni 2 parashikon që edhe subjektet e ngjashme me shkronja të ngjashme të kenë një largësi të caktuar të cilët do të mund të bëjnë të mundur atë që votuesi apo zgjedhësi të jetë i lirë dhe të mos kalojë në lajthitje në ushtrimet e të drejtës kushtetuese. Kështu që unë e besoj se është e nevojshme, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, nëse nuk ka propozime të tjera për nenin 2 hedhim në votim propozimin e zotit Prenga.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Z. D. Prenga, përfaqësues i Partisë LN: Një sqarim ndoshta u keqkuptuam, unë fola për këtë akt jo për aktin e regjistrimit, ajo preogrativë është ezauruar në atë kohë nëse nuk është bërë, është një çështje tjetër unë po them se fakti nuk ekziston se prezjurohet është e ezauruar në çast të regjistrimit thotë neni 66 KQZ-ja i konsideron të gjitha këto elemente dhe e shmang efektin e mundësisë së konfondimit apo lajthitjes së zgjedhësve. Këtu jemi një gjë krejt tjetër, këtu flitet për short.

Z. M. Çakaj: Ky moment procedural të sqaron ose të zgjidhë atë situatë hipotetike nëse kemi dy parti LN dhe LND ky moment neni 2 parashikon që të mos vendosë njeri tjetër të jenë deri në 3 apo 4 rreshta, të paktën kështu e kuptojmë ne paraqitjen e kësaj.

Znj. I. Nano: Kemi një propozim...

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Unë kam një propozim konkret për pikën 3, pavarësisht se në parim bie dakord me atë çfarë propozon zoti Prenga. Tek fjalia e fundit thuhet në rast se dhe pas hedhjes së tretë të shortit, përsëri renditen njëra pas tjetrës parti koalicioni që kanë emrin zyrtar emblemën siglën apo shkronjat nistore të përafërta, ato do të zhvendosen në renditje deri në katër rradhë duke filluar nga emri i partisë në rast se përplasja është midis parti dhe koalicionit apo nga partia e themeluar në fillim në rast se përplasja është midis dy partive. Idea ime është të përcaktohet se kush do të zhvendoset i pari në rradhë? Konkretisht do të çvendoset në renditje deri në katër rradhë më poshtë ta theksojmë, duke filluar nga partia më e hershme në regjistrim nëse përplasja është midis dy partive, apo nga partia nëse përplasja është midis partisë dhe koalicionit.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Z. M. Çakaj: Më fal nuk mund ta bëjmë në lidhje apriori sepse e përcakton shorti.

Znj. I. Nano: Hidhet shorti dhe njëra parti ose njëri subjekt del i treti, tjetri del i katërti.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Këtu thuhet ato në rast se dhe pas hedhjes së tretë të shortit përsëri renditen njëra pas tjetrës. Pra ta zemë hidhet shorti herën e tretë...

Z. M. Çakaj: E përcakton hedhja e fundit e shortit kush e merr...



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Jo, jo fjalia është ndryshe! Nëse dhe pas hedhjes së tretë ta zëmë kemi “AB” dhe “EB” dhe prap këto renditen njëra pas tjetrës, unë pyes kush do renditet pas katër rradhësh “AB” apo “EB”?

Znj. I. Nano: E fundit.

Z. M. Çakaj: “EB”-ja.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Po pse?

Znj. I. Nano: E fundit. Pra, është përcaktuar një rradhë që “AB”-ja është më sipër “EB”-ja është më poshtë.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Po nuk del këtu. Ku thuhet e fundit? Pra, për të qenë të saktë nuk thuhet.

Znj. I. Nano: Atëherë, propozimi juaj është që t’i vëmë prioritet partisë? Unë do të thoja se subjektet zgjedhore kanë të njëjtën peshë. Mund të jetë një parti dhe një koalicion me të njëjtin akronim...

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Por, jo ne në rradhë të parë...

Znj. I. Nano: Megjithatë, Drejtoria Juridike kishit diçka, ju lutem? Po zonja Koja.

Znj. M. Koja: Vetëm thjeshtë ne vijim të argumentit të paraqitur nga zoti Çakaj do të thoja pikërisht këtë gjë që Ju sapo sqaruat. Nëse do të zbresim poshtë tek procedura hedhjes së shortit të dali e qartë pikërisht ajo që Ju pohuat. Mbasi një

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*

12

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

subjekt përfaqësuesi i tij tërheq numrin, nëse përfaqësuesi i partisë me sigël të ngjashme do të tërheq numrin pas tij dhe do të jenë afër atëherë ky numër do të spostohet.”. Pra, është përcaktuar i pari është përcaktuar i pari, e ka zgjedhur. Ka tërhequr shortin i pari, sepse po të zbresim tek neni 4 do të kuptojmë më pas procedurën.

Znj. I. Nano: Parimisht unë bie dakord.. është diskutimi im tashmë.. me shqetësimin e znj. Bushati, që këtu ka nevojë për një saktësim. Gjithashtu, jam dakord me interpretimin e z. Çakaj dhe tuajin për faktin që, ai që renditet në shortin e tretë maksimalisht kemi renditjen e fundit pra, mes dy le të themi subjekteve zgjedhore me shkronja nistore të përafërta i fundit zhvendoset katër vende më poshtë. Por, mund të na qëlloj që dy subjekte me shkronjat nistore të përafërta, pra me këto karakteristika mund të jenë i fundit dhe i parafundit në short. Që do të thotë ai që është i fundit nuk ka mundësi të spostohet më poshtë pra, do të duhet t’i bëjmë një rregullim të ngjitet më lart. Deri në katër rradhë unë do të shtoja personalisht ose po e bëjë propozim konkret, sipas rastit më lart apo më poshtë në renditje.

(nuk dëgjohet)

Më poshtë apo më lart renditja zhvendosja? Nëse është i fundit dhe i parafundit, dalin dy subjekte zgjedhore me këto karakteristika njeri i fundit tjetri i parafundit. Ai i fundit nuk zhvendoset dot më poshtë pra, do të duhet ky i parafundit të zhvendoset më lart katër rradhë. Unë mendoj që është vendi për ta përcaktuar, ky është shqetësimi im.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Po, por kjo pastaj.. më fal.. Kjo pastaj heq edhe atë mundësin, atë mënyrën e interpretimit si thatë Ju. Sepse, Ju me të drejtë morët rastin kur është i fundit dhe i parafundit po mund të ndodh dhe i pari dhe i dyti.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Znj. I. Nano: I dyti zhvendoset katër poshtë.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Katër poshtë. Po atëherë Ju thoni pra, me logjikën që thatë më përpara që do të zhvendoset ai që është i dyti i bie kur është i pari dhe i dyti, zhvendoset i dyti. Ndërsa kur është i parafundit do të zhvendoset i fundit para.

Znj. I. Nano: Po, sepse nuk ka mundësi të renditet më poshtë ai që është i fundit.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Epo.. Situatat mund të jenë nga më të ndryshmet. Prandaj po them që më mirë me përcaktuar se kush është më poshtë.

(diskutimit ndërmjet stafit të Rregullatorit nuk dëgjohet)

Znj. I. Nano: Atëherë, nisur nga praktika e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sepse short për renditjen është..

Z. M. Çakaj: Më fal, se po ndërhyj përsëri. Nuk kemi pse të konfuzohemi sepse neni 3 nuk.. Atëherë, ta lexoj në mënyrë integrale “Në rast se në përfundim të hedhjes së shortit..” bëhet fjalë për të gjitha subjektet..

Znj. I. Nano: Pikën 3..

Z. M. Çakaj: Po pra, për të gjithë subjektet “..renditen në mënyrë njëri pas tjetrit subjektet të cilët kanë emrin zyrtarë, emblemës (siglën) apo shkronjat të

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

përafërta dhe që mund të shkaktojnë konfuzion apo lajthitje të votuesit, shorti përsëritet, por jo më shumë se tre herë.” Përsëritet për të gjithë pra..

(nuk dëgjohet)

Po nuk përsëritet vetëm parafundit dhe të fundit dhe e përjashton këtë situatë hipotetike..

Znj. I. Nano: Jo, fjalia e fundit thotë “Në rast se pas hedhjes së shortit të tretë përsëri renditen pranë njëra – tjetrës atëherë duhet të zhvendosen..”

(ndërhyrjet në sallë nuk dëgjohen)

Z. M. Çakaj: Po. Por, shorti përsëritet për të gjithë subjektet po për të parafundit dhe të fundit. Kështu që është e përjashtuar kjo situatë.

Znj. I. Nano: Nëse mbas shortit të tretë..

(ndërhyrja nuk dëgjohet)

Z. M. Çakaj: Si jo? Po ja pra ta sqaroj.. Më fal, ta sqaroj Drejtoria Juridike, sepse unë të paktën kështu e kam kuptuar. Është e qartë.

(ndërhyrja nuk dëgjohet)

Znj. I. Nano: Nëse pas shortit të tretë vijon të kemi këtë renditje atëherë bëhet zhvendosja.

(ndërhyrja nuk dëgjohet)

Z. M. Çakaj: Po, pra por nuk.. ndodhem në situatën hipotetike që mund të kem të parafundit dhe të fundit, sepse shorti është integral për të gjithë subjektet zgjedhore të regjistruar.

*Zbardhje materialin audio
Jonida SALILLARI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Znj. I. Nano: U hodh shorti nga e para dhe në shortin e tretë kemi këtë situatë që themi..

(nuk dëgjohet)

Z. D. Çaka: Në shortin e tretë ndodh kjo jo në të parin, në të dytin. Në shortin e tretë që ti nuk ke mundësi më të hedhësh shortin..

Z. M. Çakaj: Po, pra.. nëse hidhet dhe shorti tretë dhe ndodhemi hipotetikisht në këtë situatë rregullohet manualisht që mos të kemi atë situatë.

(nuk dëgjohet)

Z. D. Çaka: Kam përshtypjen..


Znj. I. Nano: Atëherë, unë i lutem Administratës së KQZ-së si propozuese çfarë ka pasur parasysh. Cilat janë rastër ekstreme që ka patur parasysh. Cilat raste mund të kenë ndodhur në të shkuarën dhe nëse ka një propozim konkret për ta rregulluar këtë situatë. Besoj që shqetësimi u përcoll. Qe do të thotë mund të kemi situata edhe vete neni e ka përcaktuar. Mund të kemi situata që dhe pas shortit të tretë të na ndodh kjo gjë dhe situata mund të jetë dhe ajo që unë parashikova dhe ajo që znj. Bushati parashikoj pra, i pari i dyti në listë, i fundit, i parafundit në listë pas shortit të tretë. Si kuptohet zhvendosja me katër rradhë?

Z. D. Çaka: Deri në katër rradhë.

Znj. I. Nano: Deri në katër rradhë.

Z. Y. Merkaç: Ne kur e kemi hartuar aktin kemi pasur parasysh se kur hidhen tre shortet e para do të hidhen të gjitha partitë në renditje. Ndërsa kjo është një

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

situatë hipotetike që nuk mund të ndodhi. Megjithatë ne kemi parashikuar thjeshtë zhvendoset është edhe në rendin rritës edhe në rendit zbritës në shkallë.
(nuk dëgjohet)

Znj. H. Vukaj: Kam përshtypjen edhe në referim të akteve pararendëse që kemi bërë. Pra, akteve të vjetër që kemi parë të cilat na drejtojnë në praktikën që ka përdorur KQZ-ja. Kam përshtypjen që këto situatat hipotetike mund të ndodhin edhe në shortin e parë. Po mund të ndodhin dhe në shortin e tretë dhe në shortin e katërt. Tre shorte ka në fakt, por edhe në atë variantin e katërt dhe më konfuzja apo më me risk do të thoja është fakti kur dy subjektet me sigla apo me iniciale të njëjta qëndrojnë në fund dhe parafundit. Sepse, mund të gjendet një zgjidhje në momentin kur ato ndodhen në vendin e gjatë, e shtatë dhe kemi dhe disa vende bosh dhe kemi këtë tolerancën e spostimit nga katër dhe aty mund të gjemë modusin që mund të spostohet ai që ka në rend alfabetik shkronjën më të pasme dhe të jetë prioritet ai që ka shkronjën nistore ndër kryesoret e alfabetit. Kurse problemi qëndron kur ato janë në vendin e parafundit dhe të fundit këtu do gjetur një zgjidhje praktike që mos t'i japin pastaj ditën e hedhjes së shortit. Problem që nuk.. do mbetet një ngërç i pazgjidhur.

Z. D. Çaka: Unë mendoj që përparësinë nuk mund ta marrim asnjëherë.. përparësi mund të marrim vetëm shorti i hedhur. Pra, vendi që do të ketë secili subjekt zgjedhor mbi bazën e shortit, sepse ne qoftë se ne do t'i referohemi qoftë datës së regjistrimit siç propozoj përfaqësuesja e partisë politike apo edhe kolegja për shembull me germa ne do të humbasim nocionin e shortit. Kështu që më mirë ta lemë të jetë shorti ai që do të përcaktoj dhe..

Znj. H. Vukaj: Është e vërtetë. Por, mund të ndodh që në shortin e parë ty të del problematika me "LN"-në dhe "LB"-në dhe mund të hedhësh për hir të kësaj

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

problematike shortin përsëri dhe të del problematika tek “ZP”-ja dhe tek “ZR”-ja. Të del në një dyshe tjetër.

(nuk dëgjohet)

Z. D. Çaka: Le t’i jepet përparësi..

Znj. H. Vukaj: Pra, eliminohet ajo dyshja dhe të del një dyshe tjetër. Sa herë të hidhet shorti ekziston hipotetikusht që do të ndodhin përplasje të kësaj natyre. Problemi është që tek përplasia e fundit ndoshta mund edhe të rastis që kjo është në rendin e fundit dhe të parafundit dhe cila do të jetë zgjidhja? Ose do të spostosh për lart dhe nuk do të.. *(nuk dëgjohet)*

Znj. I. Nano: Unë do të propozoja, sepse tani duke diskutuar hipotetikusht të gjitha rastet. Propozoj pesë minuta pushim të mbledhjes dhe ju lutem nga administrata të na sjellin shkronjat nistore të të gjithë subjekteve që janë regjistruara aktualisht. Pavarësisht çfarë ndodh me verifikimin e listës së..

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Më fal, të shtoj edhe një gjë. Mbase edhe mund të mos e kufizojmë tek tre herësh edhe kjo është një formë për ta mbajtur, pra për të realizuar çdo interes në hedhjen e shortit. Po them..

Znj. I. Nano: Nuk mund të bëhet pafundësisht se përsëri hipotetikusht shorti përsëritet njëllëj. Atëherë, pesë minuta pushim ju lutem të marrim shkronjat nistore të subjekteve zgjedhore që janë regjistruar.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



**Rifillon mbledhja
Ora 17:44**

Znj. I. Nano: Rifillojmë mbledhjen. Pasi kërkuam emërtimet dhe shkurtime të emrave të subjekteve zgjedhore të cilat janë të regjistruara aktualisht. Komisioni Rregullator sigurisht që këtë akt normati nuk e harton vetëm për këto zgjedhje, atë e diskutuam dhe më herët edhe pse nga sa shikojmë nuk ka potencialisht problematika. Gjithsesi duke diskutuar së bashku me anëtarët e Komisionit Rregullator edhe unë kam një propozim, propozim i konsultuar me të gjithë anëtarët. Për mendimin tim pika 3 duhet të riformulohet: në rast se në përfundim të hedhjes së shortit renditen njëri pas tjetrit subjektet zgjedhore të cilët kanë emrin zyrtar, emblemën (siglën) apo shkronjat nistore të përafërta dhe që mund të shkaktojnë konfuzion apo lajthitje tek votuesit, shorti përsëritet deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion tek votuesi. Pra ideja është të mos kemi zhvendosje por të hidhet short pafundësisht thënë me fjalë të tjera sepse zhvendosja mundet të shkaktojë ndonjë problem. Atëherë hedhim për votim 3 propozime, propozimi i zotit Prenga për ta hequr pikën 3 të nenit 2 nga akti. Votojmë propozimin për heqjen e pikës 3 të nenit 2.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: S'ka

Kundra: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Me 5 vota kundër, nuk miratohet.

Ju lutem zonja Bushati propozimin tuaj? Tërhiqeni nga propozimi?

Znj. E. Bushati, përfaqësues i Partisë LN: Po, me këtë që plotësuat ju, tërhiqem.

Znj. I. Nano: Nuk e di nëse do të votohet edhe ky propozim i imi por gjithsesi ju tërhiqeni nga propozimi juaj, faleminderit. Atëherë votojmë propozimin që

***Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

gjuhësisht do ta rishikoj administrata por me idenë që të hiqet zhvendosja dhe të vijojë përsëritja e shortit deri në një renditje korrekte që nuk shkakton konfuzion tek votuesi. Atëherë votojmë këtë propozim ju lutem për riformulimin e pikës 3 të nenit 2.

Kush është pro?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet.

Kalojmë tek neni 3, veprimet papaprake.

1. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së njofton përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore të cilët kanë regjistruar listat shumemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit.

2. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së dhe shpallet në hyrjen e saj në këndin e njoftimeve.

3. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, cakton një nëpunës të administratës së KQZ-së të tërheqë gojlën për subjektin zgjedhor, përfaqësuesi i të cilit nuk është i pranishëm.

Propozime për shtesa, ndryshime në nenin 3? Subjektet zgjedhore? Përfaqësuesit, zoti Prenga, po?!

Z. D. Prenga, përfaqësues i Partisë LN: Ndoshta vetëm një rregullim gjuhësor tek fjalia “të cilët kanë regjistruar” sepse mund te interpretohet “ato që kanë sjellë”. “Lista e të cilëve janë regjistruar” pra, e kanë fituar statusin listë e regjistruar. Ndoshta mund të ishte gjuhësisht..

Znj. I. Nano: Administrata ju lutem ta shihni gjuhësisht. Nuk është propozim për shtesë apo ndryshim.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Z. D. Prenga, përfaqësues i Partisë LN: Po vetëm rregullim gjuhësorë që të përcjellë faktin që i është regjistruar lista, tashmë ka fituar statusin juridik të regjistruar sepse edhe dikush që i sjell listat dhe nuk i ka të rregulla mund të kërkoj të vij.

Zn j. I.Nano: Propozim konkret keni për shtesa, ndryshime në këtë nen, ju lutem kolegë. Atëherë, nëse nuk ka propozime votojmë nenin 3 sipas përmbajtjes të ardhur nga Komisioneri.

Pro këtij propozimi kush është?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 3.

Kalojmë në nenin 4, procedura e shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore.

1. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short.
2. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre ku shënohet një nga numrat duke filluar nga numri 1 deri tek numri i barabartë me numrin e subjekteve zgjedhorë, pjesëmarrës në short. Shiritat e letrës janë të barabartë dhe verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit nëpërmjet ekspozimit nga Sekretari i Përgjithshëm/personi i autorizuar. Pas verifikimit, Sekretari i Përgjithshëm/personi i autorizuar i palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat vendosen në enën transparente dhe përzihen, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.
3. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore tërheqin nga ena me radhë një gogël. Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor do të hapë goglën dhe do të lexojë numrin që është shënuar në të. Ky numër do të jetë numrin rendor që subjektit zgjedhor do

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

të ketë në fletën e votimit. Administrata e KQZ mban procesverbalin e rezultatit të shortit

4.Radha e tërheqjes së goglave nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore përcaktohet me parashort, i cili zhvillohet sipas kësaj procedure:

- a) Në një enë tjetër transparente futen aq gogla sa është edhe numri i subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short.
- b) Në secilën prej goglave futet një shirit letre ku shënohet emri i subjektit zgjedhor.
- c) KQZ cakton një person nga administrata për të tërhequr goglat.
- ç) Personi i caktuar nga administrata e KQZ-së tërheq një gogël, e hap dhe lexon emrin e subjektit zgjedhor që është shënuar në shiritin brenda goglës dhe ia dorëzon Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.
- d) Subjekti zgjedhor që është shënuar në shiritin e letrës brenda goglës së parë do të jetë i pari që do të tërheq në shortin që do të zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni e kështu do të vazhdohet deri në tërheqjen e të gjitha goglave brenda në enë.

Unë personalisht kam një propozim për 2 shtesa në fakt në nenin 4. Dukeqenëse ne kemi miratuar më herët në vendimin tonë numër 3 rregulloren për organizimin dhe funksionimin e KAS-it ku parashikohet edhe procedura e shortit kemi gjetur një formulim lidhur me karakteristikat e goglave. Pra në këtë akt paraqitet procedura e tërheqjes së goglave, numri i goglave i njëjtë më numrin e subjekteve. Ndërkohë për karakteristikat e goglave ajo që ne kemi parashikuar tek rregullorja e KAS-it është dhe unë propozoj që kolegët ta shtojnë si fjali të dytë tek pika 1. “Goglat duhet të jenë të së njëjtës ngjyrë, jo transparente, pa shenja apo shënime dhe të së njëjtës peshë dhe madhësi”, kjo është ajo që kemi parashikuar tek KAS-i. Ndërkohë në pikën 4 shkronja “a” të po këtij neni ku parashikohet parashorti propozoj që fjalia e dytë të jetë “Goglat duhet të kenë karakteristikat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni”, pra nëse

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

miratojmë propozimin në pikën 1 atëherë mund të votojmë edhe në pikën 2. Nuk e di nëse ka propozime të tjera për nenin 4. Nëse nuk ka propozime të tjera lutem të votojmë nenin 4 duke filluar me ndryshimin e propozuar në pikën 1. Atëherë votojmë propozimin e parë ju lutem në pikën 1 të shtohet fjalia e dytë “Goglat duhet të jenë të së njëjtës ngjyrë, jo transparente, pa shenja apo shënime dhe të së njëjtës peshë dhe madhësi”.

Kush është dakord me këtë propozim kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet.

Dhe propozimi i rradhës është në pikën 4 shkronja a. Në fakt kemi të njëjtin formulim si tek rregullorja e KAS-it. Ngjyrë, formë? Të vendosim edhe formë të njëjtë?

Znj. H.Vukaj: Formë madje edhe përbërje të njëjtë.

Zn j. I.Nano: Atëherë, kemi edhe një propozim tjetër që goglat të jeni të së njëjtës ngjyrë dhe pas fjalës ngjyrë apo të së njëjtës peshë, madhësi, formë dhe përbërje. E rivotojmë ju lutem.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet.

Ndërsa tek pika 4 shkronja “a” propozimi është “Goglat duhet të kenë karakteristikat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni”

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Me 5 vota pro, miratohet.

Kalojmë tek neni 5, rezultati i shortit dhe ankimimi.

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton me vendim renditjen e subjekteve zgjedhore të dal nga shorti.

2. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve mund të ankimohet në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

Subjektet, kolegët, po zonja Bushati?

Znj. E. Bushati, përfaqësues i Partisë LN: Unë vetë isha e propozimit të cilin më pas e shtjelluat edhe ju, deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion. Mendoj që tek neni 5 ti japim një mundësi subjekteve që të bëjnë ndonjë pretendim të mundshëm para vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pra nga momenti i hedhjes së shortit deri në daljen e Komisionerit me vendim, ti jepet një mundësi për paraqitjen e ndonjë mendimi hipotetik mbi shortin.

Znj. I.Nano: Në fakt përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore janë të pranishëm gjatë hedhjes së shortit, e shohin në mënyrë të drejtperdrejtë, janë pjesëmarrës në proces sepse janë ata që tërheqin numrat dhe pastaj ky proces i gjithi finalizohet me një vendim. Pra seanca është publike.

Znj. E. Bushati, përfaqësues i Partisë LN: është plotësisht e qartë por po mendoja kur formuam pjesën që “Deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion” kush e përcakton këtë? Kush i vendos vulën që kjo është renditja që nuk shkakton konfuzion?

Znj. I.Nano: Fjalja vazhdon, konfuzion për zgjedhësit. Konfuzioni lidhet me nenin 66 dhe me atë që u theksua më herët në nenin 2, në parashikimet e nenit 2. Pra në këtë rast vendimi i Komisionerit formalizon procedurën e zhvilluar në

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

prani të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Megjithatë kemi më pas të drejtën e ankimit, çdo kontestim behet drejtperdrejt aty, në seancën ku hidhet shorti. Keni propozim konkret për këtë gjë? Për riformulim, shtesë, ndryshim? Kolegë? Nëse jo, kalojmë në votim. Votojmë nenin 5 sipas propozimit të Komisionerit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet.

Neni 6, shfuqizim.

Udhëzimi nr. 3, datë 4.3.2015, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për procedurën e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit”, për rregullat dhe procedurat e hedhjes së shortit për zgjedhjet në Kuvend, shfuqizohet.

Kalojmë në votim, nuk besoj që ka diskutime për këtë nen apo propozime për të mos e shfuqizuar.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet.

Neni 7, hyrja në fuqi.

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kolegë ju ftoj të votojmë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Jona DERYISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.11.03.2021*

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 7.

Votojmë në tërësi projektvendimin pasi kemi votuar ne parim, kemi votuar nen për nen, ka pësuar disa ndryshime projektvendimi nga propozimi.

Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro sapo kemi miratuar vendimin për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Duke ju falenderuar e deklaroj mbledhjen të mbyllur. Natën e mirë!

Vendimi nr.10

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

